



Pranuar / Dorezuar Prinjenol/Prodato Received/Delivory	24.07.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtup e Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	5345/2023		1/8



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.779/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, dhe Kaltrina Avdullahi Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.779/2023 të datës 25.05.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avokati [redacted] me adresi [redacted] Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike "masë disiplinore-largim nga shërbimi civil", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 24.07.2023 mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa më numër A.nr.779/2023 e datës 25.05.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]
- II. ANULOHET Vendimi me numër reference Nr.ref. 157/2023 i datës 26.04.2023 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.
- III. OBLIGOHET Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të bëjë zbatimin e këtij vendimit, të bëjë rishqyrtimin e këtij rasti.
- IV. Obligohet Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Dispozitës që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën III.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr. 132/2022 të datës 07.07.2022 në pozitën e punës "Drejtor i Departamentit për Amerikë" në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 28.03.2023 Zëvendësuesi i Sekretarit i Përgjithshëm në cilësinë e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejtë ka parashtruar kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore në Komisionin Disiplinor me arsyetimin se: "Ekziston dyshimi i bazuar se ankuesi në cilësinë e Drejtorit të Departamentit për Amerikë në periudhën kohore nga data 07.07.2022 e deri më tani, ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës të përcaktuar me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë gjatë ushtrimit të funksionit të tij si Drejtor i këtij Departamenti".

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 29.03.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. Ref: 99/2023 përmes të cilit ka bërë pezullimin e marrëdhënies së punës së ankuesit deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës pas zhvillimit të procedurës disiplinore më datë 26.04.2023 ka nxjerr Vendim me numër të referencës Nr.ref.157/2023 përmes të cilit ankuesin e ka shpallur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.2, 3.3, 3.6, 3.8 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar ankuesit masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil", duke shtuar se masa disiplinore bazohet në nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi kundër Vendimit me numër reference Nr.ref. 157/2023 të datës 26.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 25.05.2023 përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokatit ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 4418/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se Vendimi me numër reference Nr.ref 157/2023 i datës 26.04.2023 përmban shkelje procedurale dhe materiale.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.06.2023 Këshilli ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli më datë 16.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me Vendimin me numër të protokollit 5079/2023 të datës 06.06.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vazhduar afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.779/2023 të datës 25.05.2023 edhe dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesa me numër protokoll 4418/2023 e datës 25.05.2023 e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër reference Nr.ref.157/2023 i datës 26.04.2023 i Komisionit Disiplinor në MPJD; Vërejtje me numër reference Nr.ref.287/2022 e datës 02.09.2022; Vërejtje me numër reference Nr.ref. 311/2022 e datës 16.09.2022; Vërejtje me numër reference Nr.ref.24/2023 e datës 01.02.2023; Vendim me numër A.nr.417/2023 i datës 24.03.2023 i KPMSHCK; Vendim me numër A.nr.216/2022 i datës 14.04.2022 i KPMSHCK; Plani individual i punës për vitin 2023 i datës 30.01.2023; Vërejtje me numër reference Nr.ref.13/2023 e datës 23.01.2023; Vendim me numër A.nr.445/2023 i datës 14.04.2023 i KPMSHCK; E-mail i datës 15.11.2022; E-mail i datës 08.09.2022; E-mail i datës 16.08.2022; Kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore e datës 28.03.2023; Vendim për pezullimin e marrëdhënies së punës me numër reference Nr.ref.99/2023 i datës 29.03.2023; E-mail i datës 11.05.2022; Vendim me numër A.nr.461/2022 i datës 01.07.2022 i KPMSHCK; E-mail i datës 10.05.2023; E-mail i datës 18.08.2023; E-mail i datës 09.08.2023; E-mail i datës 05.08.2022; E-mail i datës 10.08.2022; E-mail i datës 25.07.2022; E-mail i datës 21.07.2022; E-mail i datës 08.09.2022; Procesverbal i takimit në mes Departamentit për Amerika (DA) dhe diplomatëve të SHBA-ve në Kosovë i datës 07.09.2022; E-mail i datës 20.01.2023; E-mail i datës 11.10.2022; Miratim Paraprak për Projekt-rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës i datës 24.12.2021; Kërkesë nga MPJD për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor të Projekt Rregullores për Organizimin dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës e datës 05.01.2022; Vendim me numër 214/2022 i datës 01.02.2022; Vendim me numër A.nr.413/2020 i datës 04.02.2023 i KPMSHCK; Raport Javor i datës 10.03.2023; Raport Javor i datës 17.03.2023; Autorizim i datës 04.05.2023; E-mail i datës 21.03.2023; E-mail i datës 17.08.2022; E-mail i datës 28.03.2023; E-mail i datës 02.09.2022; E-mail i datës 19.09.2022; E-mail i datës 16.09.2022; E-mail i datës 29.03.2023; E-mail i datës 31.01.2023; Listë e datës 01.12.2022; Listë e takimit javor me drejtorët politikë të MPJD e datës 31.08.2022; Listë e takimit javor me drejtorët politikë të MPJD 05.08.2022; Listë e takimit javor me drejtorët politikë të MPJD e datës 16.09.2022; Listë e takimit javor me drejtorët politikë të MPJD e datës 09.09.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë 13.06.2023; Përgjigje në ankesë e datës 16.06.2023; Fletkthesë; E-mail i datës 12.04.2023; Procesverbal i mbledhjes së komisionit disiplinor i datës 18.04.2023; Procesverbal i mbledhjes së komisionit disiplinor i datës 29.03.2023; Procesverbal i mbledhjes së komisionit disiplinor i datës 18.04.2023; Procesverbal i mbledhjes së komisionit disiplinor i datës 26.04.2023; E-mail i datës 26.04.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar që janë përmbushur kushtet ligjore që lënda të kthehet në *rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër të referencës Nr.ref.157/2023 të datës 26.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për shqiptimin e masës disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil", pretendon se iniciimi i procedurës disiplinore është bërë nga personi jo kompetent ngase Sekretari i Përgjithshëm ka disa muaj që ka tejkalluar çdo afat

kohor të përcaktuar me ligj për të mbajtur pozitën e Zëvendësuesit dhe në këtë rast i njëjti nuk është Udhëheqësi i tij i Drejtpërdrejtë; Prononcimin e tij në media konkretisht në programin "Info Magazinë" e ka bërë me autorizimin e Shoqatës Sindikale të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës lidhur me protestën që ka mbajtur e njëjta ngase ankuesi është anëtarë i kësaj organizate; Për sa i përket udhëzimeve për ambasadat e gjeografisë i njëjti pretendon se ka mbulueshmëri përmes komunikimeve elektronike drejtuar zyrtarëve kompetent e gjithashtu edhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë; Ndërsa lidhur me kontestimin e akteve nënligjore të lëshuara nga institucionet shtetërore konkretisht Vendimet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve si dhe Vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyes Civil të Kosovës, ankuesi pretendon se është e drejtë Kushtetuese dhe ligjore që secili person që mendon se me një Vendim apo akt juridik i është cenuar ndonjë e drejtë si palë në procedurë mund të përdorë mjetet juridike në këtë rast mjetin e rregullt juridik ankesën nëse interesat e tij preken thelbësisht.

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, rrjedhimisht i njëjti sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.132 të datës 07.07.2023 ushtron pozitën e punës "Drejtor i Departamentit për Amerikë".

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit dhe analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të kundërshtuar me ankesë respektivisht Vendimit me numër reference Nr.ref. 157/2023 të datës 26.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, i'u referuar dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë lidhur me procedurën disiplinore të nëpunësve civilë, përkatësisht:

Nenit 45 ka përcaktuar se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit".

Nenit 46 ku citohet se: 1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta... ndërsa "Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasojë të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose nuungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjisllacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë".

Nenit 47 ka përcaktuar se: "Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil".

Nenit 50, ka përcaktuar se: "1. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit". 2. Masat disiplinore jepen në raport të drejtë me shkeljen e kryer. 3. Për shkeljet e rënda, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafët 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji. 4. Për shkeljet e lehta, jepen masat disiplinore të përcaktuara në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji. 5. Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të dëshmive të ofruara në lëndë, ka konstatuar se Zëvendësuesi i Sekretarit i Përgjithshëm në cilësinë e Mbikëqyrësit të Drejtpërdrejtë më datë 28.03.2023 ka parashtruar kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore në Komisionin Disiplinor ndaj ankuesit nën dyshimin e bazuar se ankuesi me veprimin e tij ka kryer shkelje të rëndë të obligimeve dhe përgjegjësi të punës, sipas nenit 46 paragrafit 3, nën paragrafit 3.1, 3.2, 3.3, 3.6, 3.8 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë, respektivisht me arsyetimin se: "Ekziston dyshimi i bazuar se ankuesi në cilësinë e Drejtorit të Departamentit për Amerikë në periudhën kohore nga data 07.07.2022 e deri më tani, ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës të përcaktuar me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë gjatë ushtrimit të funksionit të tij si Drejtor i këtij Departamenti gjegjësisht i njëjti : 1. Nuk e ka respektuar hierarkinë dhe autoritetin e Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD-së, respektivisht duke tejkaluar hierarkinë, ka caktuar dhe ka mbajtur takim jashtë institucionit, 2. Pa pëlqim nga Ministria, pra pa autorizim nga Ministria, ka bërë prononcime publike lidhur me punën e MPJD; 3. Ka komunikuar dhe ka dërguar dhe ka dhënë udhëzime për ambasadat e gjeografisë që e mbulon, pa qenë në dijeni dhe pa koordinim dhe pëlqim nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë/ Sekretari i Përgjithshëm; 4.Ka cenuar imazhin e institucionit ashtu që në publik ka kontestuar ligjshmërinë e akteve nënligjore edhe pas konfirmimit me shkrim nga institucionet përkatëse konkretisht vendimeve të Kryeministrit, konfirmimeve nga Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve, si dhe Vendimeve të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në MPJD, e cila konstatohet se është në përputhje të plotë me bazën ligjore në fuqi. Ndërsa Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës më datë 26.04.2023 ka nxjerr Vendim me numër të referencës Nr.ref.157/2023 përmes të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil ", për shkak se me veprimet e tij ankuesi ka kryer , shkelje të rënda disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.2, 3.3, 3.6, 3.8 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me rastin e nxjerrjes se Vendimit me numër të referencës

Nr.ref.157/2023 të datës 26.04.2023, me të cilin i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore *“Largim nga Shërbimi Civil”* ka vepruar në kundërshtim nënin 11 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, i cili përcakton se *„Komisioni disiplinor ka këto kompetenca: 1.1. „Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura” dhe 1.2. Përcakton dhe shqipton masën disiplinore”* dhe në kundërshtim me nenin 13 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik ku përcaktohet se; *„Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 4.1. Shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 4.2. Shkallën e fajësisë; 4.3. Ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të Ligjit; 4.4. Përpyekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit”* sepse në rastin konkret edhe përkundër faktit se ndaj ankuesit janë shqiptuar katër (4) masa disiplinore - Vërejtjet si në vijmë: *“ Vërejtja me Nr.ref. 287/2022 e datës 02.09.2022, Vërejtja Nr.ref.311/2022 e datës 16.09.2022, Vërejtja Nr.ref.13/2023 e datës 23.01.2023, Vërejtja me Nr.ref.24/2023 të datës 01.02.2023”*, mirëpo sipas provave të lëndës, këto masa kanë qenë të shqiptuara për shkelje të lehta të kryera nga ana e ankuesit, respektivisht Kolegji konstaton se Komisioni Disiplinor nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë provat dhe faktet, përkatësisht nuk ka marrë për bazë faktin se ankuesit asnjëherë nuk i është shqiptuar masa disiplinore për shkelje të rënda dhe i njëjti pa marrë për bazë të gjitha këto faktet juridike dhe të provueshme ka shqiptuar masën më të rëndë disiplinore ndaj ankuesit respektivisht *“Largim nga Shërbimi Civil”*, andaj mbi këtë bazë Komisioni Disiplinor si organ administrativ nuk duhet të marrë gjithësesi si rrethanë rënduese vetëm faktin se ndaj një nëpunësi civil janë shqiptuar masa disiplinore për shkelje të lehta disiplinore e të njëjtat të përkthehen si prova rënduese, respektivisht Komisioni Disiplinor duhet të shqyrtoj të gjitha pretendimet e inicuesit të procedurës disiplinore në raport të drejtë me shkeljet e supozuara dhe me provat materiale si dhe të marrë për bazë edhe rrethanat lehtësuese e të cilat do të ishin si fakte në procedurë administrative.

Kolegji po ashtu ka konstatuar se ndaj ankuesit për të njëjtin supozim të shkeljes i janë shqiptuar dy masa disiplinore *“vërejtje me shkrim”*, nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë me date 02.09.2022 dhe 16.09.2022 andaj mbi bazë të kësaj Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 50 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Për çdo shkelje, jepet vetëm një masë disiplinore”*, meqenëse Komisioni Disiplinor i ka shqiptuar ankuesit masën disiplinore për të njëjtën rrethanë që i është shqiptuar një masë tjetër brenda një afati të shkurtër kohor, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Vendimi me numër të referencës Nr.ref.157/2023 i datës 26.04.2023 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, është i paligjshëm dhe është në kundërshtim të plotë me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3, 1.5 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Duke marr për bazë pretendimet që janë theksuar në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit dhe marr për bazë Vendimin me numër reference Nr.ref. 157/2023 të datës 26.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës me rastin e vendimmarrjes në këtë procedurë nuk ka shqyrtuar në mënyrë të drejtë provat materiale të lëndës, ngase nuk ka dhënë shpjegim të qartë të situatës faktike duke vepruar në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim"*. Po ashtu Kolegji i Këshillit gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të kontestuar me ankesën e ankuesit, konstaton se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me rastin e shqyrtimit të rastit të ankuesit nuk ka arritur të konstatoj saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore siç parashihet me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rrjedhimisht Vendimi me numër reference Nr.ref. 157/2023 i datës 26.04.2023 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nuk përmban dispozitiv të qartë, po ashtu edhe arsyetimi është kundërthënës dhe i paqartë siç parashihet me nenin 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ndërsa arsyetimi i tij është në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 48 të këtij ligji, i cili parasheh se: *"Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij"*.

Nga të lartcekurat, Kolegji i Këshillit, meqenëse konstatoj se Vendimi me numër reference Nr.ref. 157/2023 i datës 26.04.2023 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është nxjerr si rezultat i shkeljeve procedurale dhe materiale, atëherë i njëjti sipas Kolegjit të Këshillit është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5, dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që në kuptim të dispozitave ligjore të zbatueshme të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 48 dhe nenit 11 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, ku janë përcaktuar kompetencat e Komisionit Disiplinor, Kolegji i Këshillit konstaton se Komisioni Disiplinor i Punëve të Jashtme dhe Diasporës në pajtim me dispozitat ligjore të lartë cekuar, ka mandat të dëgjoj dhe shqyrtoj provat në lidhje me shkeljet e supozuara dhe që në bazë të provave të prezantuara të vendos nëse është kryer shkelja e supozuar si dhe të përcaktojë masën disiplinore, andaj Komisioni Disiplinor me rastin e rishqyrtimit të rastit disiplinor të inicuar ndaj nëpunësit është i obliguar që të vlerësoj të gjitha provat dhe të vendos për shqiptimin e masës disiplinore në proporcion me shkeljen e konstatuar, në pajtim me nenin 50 paragrafin 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë të Republikës së Kosovës si dhe dispozitat përkatëse ligjore dhe nënligjore për procedurën dhe masat disiplinore në shërbimin civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.779/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokai
- Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.